Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër:01/12
Datë: 29.02.2012

Bazuar në nenin 142, me të gjitha pikat të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 pika 3 me nënpikën 3.2, nenin 26 me të gjitha pikat, nenin 50 pikat 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L- 189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 38 të Ligjit për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, nenin 7 pika 2 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nxjerrë:

VENDIM

1. Bleta Kadriu ngarkohet për kryerjen e detyrave të shtesë si planifikimi dhe përgatitja e buxhetit të AKK për secilin vit, përgatitja e lëndëve për pagesë, pjesëmarrja në takimet e ndryshme për buxhet dhe hartimi i raportimeve dhe plotësimi i formularëve të ndryshëm për buxhetin si dhe shpenzimet e AKK sipas kërkesave nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Financave.

2. Bleta Kadriu ngarkohet që të kryej detyrën e procesmbajtësit të Këshillit Drejtues të AKK, ku do të kryej detyrat që dalin nga Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të AKK.

3. Bleta Kadriu ngarkohet për kryerjen e detyrave të personelit të AKK duke mirëmbajtur dosjet e personelit, llogaritjen e pushimeve dhe vendosjen e tyre në dosje të stafit të AKK. Këtu përfshihen edhe hartimi i raporteve dhe formularëve të ndryshëm sipas kërkesës së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Administratës Publike.

4. Bleta Kadriu për këto funksione shtesë do kompenzohet me pagesë sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe për shkak të funksionimit dhe operimit efikas të AKK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Bleta Kadriu
2. Divizionit të personelit
3. Zyrës së Drejtorit të AKK
4. Arkivit.

Teuta Danuza,
Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve